

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEGA NË SHTERPCË
OSNOVNI SUD UROSEVAC - OGRANAK U STRPCE

NË EMËR TË POPULLIT

Me
Data

13.04.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTERPCË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Ferizaj, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.667-4/16 të dt.10.02.2017 për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor, me dt.03.03.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.667-4/16 të dt.10.02.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse me datën 19.04.2016 rreth ores 11:30 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Zhvillim Ekonomike në Shtërpçë, në rajonin ekonomik pyjorë Stani Doganit, me qëllim vjedhje ka prerë 5 drunj të llojit ahu, me diametër 30-50 m, në lartësi prej 18-21 m, gjithsejtë në kubaturë prej 3,39 m3, vlera e demit të shkaktuar është 457,65 €.

Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së.

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës [REDACTED] në [REDACTED] t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 457,65 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.667-4/16 të dt.10.02.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, për veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht shiqimin e fletparaqitjes të ushtruar nga ana e [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] me nr.61/2016 dt.14.04.2016, dhe procesverbalin me numër të njëjtë, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës [REDAKTUAR] t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 457,65 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEGA NË SHTËRPECË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.30/2017 dt.03.03.2017

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shaban

UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.